



Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas nenit 17.b të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 57.6 dhe 57.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/25, Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 Korrik 2008, miratoi:

Rregulli 10 mbi Ndryshimin e Rregullës Mbi Themelimin e Forumit të Arbitrazhit

Neni 1 Definimet

Në këtë rregull përveç nëse konteksti sugjeron ndryshe

Arbitrazhi nënkupton procedurën e zgjidhjes së kontesteve në të cilin një palë e tretë neutrale (arbitri) nxjerre një vendim pas shqyrtimit, në të cilën të dyja palët e kanë mundësinë të dëgjohen.

Arbitri apo Arbitrat nënkupton individin apo grupin e individëve (panelin) të caktuar nga miratimi i të dy palëve apo nëse është e nevojshme nga intervenimi i BQK-se për të drejtuar arbitraritetin për të zgjedhur kontestin

Paditës është personi i cili ka të drejte për të paditur dhe të kërkoj zgjidhjen apo pagesën e përfitimit apo përfitimeve të duhura nën termat dhe kushtet e kontratës siguroese. Paditësi përfshin çdo apo të gjithë policmbajtesit të siguar, përfituesit apo pala e trete paditëse .

Arbitrimi nënkupton procedurën e zgjidhjes së një kontesti

Neni 2 Të drejtat e përfituesit në procedurën e arbitrazhit

Asnjë kompani e licencuar e sigurimit apo ndërmjetës i sigurimeve, nuk mund të mohojë arbitrimin e një kontesti, nëse procedura e arbitrazhit është kërkuar nga përfituesi i një police të sigurimit. E drejta e përfituesit të një police të sigurimit për të dorëzuar dosjen në

arbitrazhe është çështje vullnetare. E drejta për të dorëzuar kërkesën në arbitrazh duhet të ushtrohet brenda afatit të përcaktuar me ligj nga ndodhja e një rasti të siguar apo ndodhje të cilat rezultojnë në një dëm. Pala ka të drejtë të i drejtohet arbitrazhit pas shfrytëzimit të mjeteve juridike brenda kompanisë së sigurimit në të kundërtën padia do të hudhet poshtë së e parakohshme.

Neni 3 **Juridiksioni i panelit të arbitrazhit**

Arbitrazhi mund të zgjedhë të gjitha çështjet të cilat janë të lidhura me detyrimin nga një police, shtrirja e një humbje apo dëmi dhe çështjeve tjera të lidhura me kushtet e kontratës së sigurimit (policës).

Neni 4 **Forumi i arbitrazhit**

Siguruesit e licencuar, degët e siguruesve të jashtëm dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve duhet ta themelojnë një forum të arbitrazhit i cili do të funksionojë si një zyre për organizimin e seancave të arbitrazhës, mirëmbajtjen e listës së arbitrave dhe udhëheqjen e funksioneve tjera të nevojshme për panelet e arbitrazhës, si dhe njoftimin e palëve me vendimet e panelit të arbitrazhës.

Neni 5 **Lista e arbitrave**

5.1 Forumi i arbitrazhit duhet ta dorëzojë në BQK një listë të personave të cilët mund të zgjidhen si arbitra sipas këtij rregulli.

5.2 Personat e zgjedhur për listën e arbitrave duhet të jenë individë me integritet të lartë, ndershmëri dhe të kenë njohuri adekuate dhe të jenë kompetent të gjykojnë çështjet të cilat lidhen me sigurime.

5.3 Individët të cilët janë ushtrues apo anëtar të institucioneve për avokim të klientëve në Kosovë, duhet të përfshihen në panelin e arbitrazhit

5.4 BQK e ka të drejtën për të pranuar apo përjashtuar persona nga lista e arbitrave.

5.5 Lista e arbitrave numëron deri në 15 persona.

Neni 6 **Zgjedhja e panelit të arbitrazhit**

6.1 Një panel i arbitrazhit themelohet për çdo rast, kështu që pala pretenduese (parashtruesi i kërkesës për arbitrim) e zgjedh një arbitër nga lista e arbitrave dhe kompania e licencuar e zgjedh një arbitër tjetër nga kjo listë. Dy arbitrat e emëruar së bashku e zgjedhin arbitrin e tretë i cili do të jetë edhe kryetar i panelit të arbitrazhit.

6.2 BQK mund të emërojë cilindo nga arbitrat, nëse pala pretenduese (paditëse), kompania e licencuar apo arbitrat e emëruar nuk emërojnë një arbitër në afatin prej 15 ditësh nga dita kur njëra pale është përcaktuar për arbitrin.

Neni 7

Procedura e përjashtimit të arbitrave

7.1 Arbitrat duhet të jenë të pavarur në lidhje me palët të përfshira në rast dhe nuk mund të punojnë apo të kenë ndonjë interes nga cila do palë.

7.2 Për rastet e përjashtimit të arbitrave në procedurë do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi procedurën kontestimore.

Neni 8

Procedurat e arbitrazhës

Arbitrat mund të kërkojnë që palët të dorëzojnë dokumentet të cilat i përshkruajnë detalet e palës pretenduese (paditëse) dhe fakte tjera për të cilat ata e konsiderojnë të nevojshme për ta sqaruar rastin.

Neni 9

Shpenzimet e arbitrazhës

9.1 Shpenzimet rreth funksionimit të zyrës së arbitrimin duke përfshirë, shpenzimet administrative, shpenzimet për vendin, furnizimet dhe materialet si dhe shpenzime tjera të arsyeshme dhe të nevojshme për arbitrazhin do të paguhet nga kompanitë e sigurimit.

9.2 Kurse shpenzimet rreth procedurës së zhvilluar në kontestin konkret duke përfshirë mëditjet e arbitrave, shpenzimet për ekspert, si dhe shpenzimet tjera të nevojshme për arbitrazh dhe rreth procedurës së arbitrimin do të i bart pala që humb kontestin.

9.3 Me qëllim të kryerjes sa më të suksesshme të procedurës së gjithmbarshme dhe varësisht nga ndërlíkueshmëria e lëndës kontestuese nga palët duhet të kërkohet të bëjnë deponimin e një shume parash në emër të shpenzimeve siç e përcakton Rregullorja e punës së Arbitrazhit.

9.4 Po që se pala nuk deponon shumën e parave nga pika paraprake në afatin prej 15 ditësh, atëherë konsiderohet se ka tërhequr kërkesën për arbitrim.

Neni 10

Vendimi i arbitrazhës

Vendimi i marrë nga arbitrat është detyrues, i formës së prerë, ka fuqinë e titullit përmbarues dhe as kompania e sigurimit e as pala pretenduese (paditëse) nuk mund të ankohen në gjykatë ose në ndonjë panel tjetër të arbitrazhit apo të iniciojnë kontest për të njëjtën çështje dhe për përmbarimin e tij është kompetente gjykata.

Neni 11

Mjetet juridike

Kundër vendimit të panelit të arbitrazhit, palët (siguruesi dhe përfituesi i polices së sigurimit) kanë të drejtë ushtrojnë padi për anulimin e vendimit të arbitrazhit, në rastet e caktuara në pajtim me nenin 36 të Ligjit për arbitrazhin.

Neni 12

Dëmet më të vogla se 1,000 Euro

Vetëm një arbitër është i nevojshëm për të zgjidhur rastet e kontesteve në shumë deri 1,000.00 Euro ose më pak. Në këtë rast BQK duhet ta zgjedh arbitrin.

Neni 13

Detyrat dhe detyrimet e arbitrave

Udhëheqja apo drejtimi i arbitrazhës duhet të jetë i drejtë dhe i barabartë për të dyja palët.

Neni 14

Njoftimi paraprak

Të gjitha seancat e arbitrazhës kërkojnë së paku dhjetë (10) ditë njoftim paraprak, për palët, përveç nëse për një njoftim të tillë është hequr dorë sipas nënshkrimit të palës të cilës i është dedikuar njoftimi. Njoftimi duhet të dërgohet palëve me post apo me korrier, në atë mënyrë që palët ta jenë të njoftuar dhjetë (10) ditë pasi që mosmarrëveshja të jetë pranuar nga arbitrat.

Neni 15

Pjesëmarrja e palëve

Arbitrat duhet të bëjnë përpjekje për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre të autorizuar, gjatë shqyrtimit të rastit. Arbitrat mundën nëse ata e konsiderojnë të nevojshme

dhe të arsyeshme, ta deklarojnë mosparaqitjen e njërës palë dhe të fillojnë seancën e arbitrazhës në mungesë të palës, duke u siguruar se njoftimi paraprak është vërtetuar.

Po qe se ne shqyrtim nuk merr pjese pala e cila ka iniciuar procedurën dhe nuk e ka arsyetuar mungesën, procedura do te përfundoj duke konsideruar se ka tërhequr kërkesën.

Neni 16

Periudha e marrjes së vendimit

Arbitrat duhet ta japin vendimin e tyre me shkrim për rastin, brenda dhjetë (10) ditëve, duke e llogaritur nga data kur shqyrtimi i rastit të ketë përfunduar.

Neni 17

Regjistrimi i seancave

Forumi i arbitrazhe duhet ti regjistrojë të gjitha dokumentet e dorëzuara në panelin e arbitrazhes, vendimet e shkruara dhe arsyeshmërin ligjore të dhënë nga paneli i arbitrazhit.

Regjistrimi i arbitrazhit do te mbahet si konfidencialë nga forumi i arbitrazhit. Informacionet lidhur me arbitrazhin mund ti lëshohen vetëm BQK-se me kërkesë te shkruar.

Neni 18

Mbajtja e shënimeve

Forumi i arbitrazhës duhet ti mbajë dhe ti sigurojë shënimet e arbitrazhës për një periudhë prej së paku pesë (5) vite nga data e vendimit.

Neni 19

Raportimi në BQK

Forumi i arbitrazhës duhet të dorëzojë një raport për seancat e mbajtura dhe vendimet e marra të arbitrazhës, në BQK, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëshit të parë të Janarit, Prillit, Korrikut dhe Tetorit, të çdo viti.

Neni 20

Punët administrative teknike

Punët administrative – teknike për forumin e arbitrazhës i kryen administrata e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës

Neni 21

Nëse me këtë rregull nuk është përcaktuar ndryshe dhe në rast të zbrazëtirave të mundshme juridike do të aplikohen dispozitat e rregullores së punës së arbitrazhit të aprovuar nga BQK-ja dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 22 **Dispozitat Kalimtare**

Derisa të themelohet forumi i arbitrazhit dhe seancat e arbitrazhës të fillojnë së funksionuari, mosmarrëveshjet të cilat përfshinë shlyerjen dhe pagesën e një dëmi në sigurime të përshkruara sipas këtij rregulli, duhet të shqyrtohen sipas iniciativës së BQK, sipas udhëzimeve në vijim:

22.1 Çdo parashtrues i kërkesës për kompensim dëmi i cili e konteston shlyerjen apo pagesën e një dëmi në sigurime, atëherë kur sistemi intern i një kompanie të licencuar dështon në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mund të dorëzojë kërkesën e saj për këtë kompensim apo mosmarrëveshje në BQK.

22.2 BQK e vlerëson dëmin dhe çështjet e kësaj mosmarrëveshje, dhe nëse e konsideron se dëmi dhe çështja janë të arsyeshme dhe të justifikuar, mund të vendosë mosmarrëveshjen vetë, apo mund të emërojë një panel të pavarur të arbitrazhës për ta shqyrtuar dhe për të vendosur për rastin.

22.3 Udhëheqja e arbitrazhës, sipas kësaj iniciative duhet të jetë konform udhëzimeve të përshkruara sipas nën-nenit 2, neni 3, të këtij rregulli.

22.4 Vendimi i mosmarrëveshjeve sipas kësaj iniciative është detyrues si për kompaninë e sigurimit po ashtu edhe për parashtruesin e kërkesës për kompensim.

Neni 23

Forum i Arbitrazhes sipas listës së miratuar nga BQK-ja në seancën e parë do të propozoj rregulloren e punës e cila do të i nënshtrohet aprovimit nga BQK-ja.

Neni 24

Me hyrjen ne fuqi te këtij rregulli do te shfuqizohet rregulli 28 Mbi Themelimin e një Forumi te arbitrazhit për te zgjedhur kundërshtimet mbi demet.

Neni 25 Hyrja ne fuqi

Kjo rregull si e ndryshuar do te hyjë në fuqi me datë 29 Korrik 2008.

Hashim Rexhepi

Guvernator
Banka Qendrore e Republikës se Kosovës